RTK RADIO TELEVIZIONI I KOSOVËS
RADIO TELEVIZIJA KOSOVA
RADIO TELEVISION OF KOSOVO
RADIO
Nr. 0014/22
Data 29.01.2022
PRISHTINË

BORDI I RADIOTELEVIZIONIT TË KOSOVËS, në bazë të nenit 29, paragrafi 2.7 të Ligjit Nr. 04/L-046, për Radiotelevizionin e Kosovës, dhe në bazë të nenit 17 paragrafi 7, të Statutit të Radiotelevizionit të Kosovës, Bordi i RTK-së merr:

Vendim

1. Për shkarkimin e z. **Mentor Shalës** nga pozita e zëvendësdrejtorit të përgjithshëm të RTK-së.

Arsyetim

UD i Drejtorit të Përgjithshëm të RTK-së, duke u bazuar në nenin 33 paragrafi 1.2, nenin 31 paragrafi 2 nënparagrafi 2.2 dhe nënparagrafi 2.3, të Ligjit 04/L-046 për Radiotelevizionin e Kosovës (G.Z. nr. 7, 27 prill 2012), nenin 8 paragrafi 2, nenin 19 paragrafi 9, nenin 20 paragrafi 12 dhe 14, nenin 22 paragrafi 1 dhe 2 të Statutit të Radiotelevizionit të Kosovës (nr. 0001/22 të datës 16.01.2022), nenin 7 paragrafi 2 të Rregullores për Kompetencat dhe Përgjegjësitë e Radiotelevizionit të Kosovës (nr. 1355/17 të datës 29.11.2017), nenin 7 paragrafi 1.1, 1.7 dhe 1.21 të Rregullores për Përgjegjësitë Materiale dhe Disiplinore të RTK-së (nr.0736/18 të datës 05.06.2018) si dhe Vendimit të Bordit të RTK-së me Nr. protokolli 0005/22, të datës 19.01.2022 për shkarkimin e Drejtorit të Përgjithshëm të RTK-së, i ka propozuar Bordit të RTK-së, që të shkarkojë zv. Drejtorin e Përgjithshëm të RTK-së për arsyet si më poshtë.

Mentor Shala, i punësuar në Radiotelevizionin e Kosovës ka kryer këto funksione menaxheriale në RTK: Drejtor i Përgjithshëm nga viti 2012 deri në vitin 2018; shef i mediave online 2018-2020 dhe nga viti 2020 kryen funksionin e zv. drejtorit të Përgjithshëm. Paralelisht, ai vazhdon të mbajë pozitën e shefit të mediave online edhe në kohën sa është zëvendësdrejtor i Përgjithshëm.

Gjatë kohës së kryerjes së funksioneve të mësipërme, Mentor Shala në vazhdimësi dhe në mënyrë të përsëritur ka shkelur Ligjin për RTK-në, Rregulloret e Brendshme qoftë duke vepruar në kundërshtim me ligjin dhe aktet e brendshme duke mos ruajtur paanshmërinë dhe duke shprehur hapur qëndrime politike e duke përdorur gjuhë seksiste përderisa mbante zyrtarisht pozita menaxheriale në RTK. Z. Shala po ashtu nuk ka vepruar në pajtim me kompetencat, detyrat dhe përgjegjësitë që ja jep ligji për të ndërmarrë masa për përmirësimin e gjuhës denigruese dhe verifikimin e lajmeve të publikuara si dhe duke bërë lajm deklarimet e të punësuarit të RTK-së i cili ka të shqiptuar masë disiplinore. Po ashtu, përveç dështimit të përmirësimit të situatës financiare gjatë kohës sa ka qenë Drejtor i Përgjithshëm, e ka rënduar edhe më tej duke rritur borxhin e RTK-së dhe numrin e punëtorëve jo të rregullt.

Shkelje tjera janë edhe veprimi që përbën angazhimi publik promocional në dëm të misionit të RTK-së si transmetues publik, duke përfshirë dhe angazhimet dhe deklarimet politiko-editoriale, si dhe veprimi kundër apo në dëm të interesave të RTK-së.

Shkelja e Rregullores për përgjegjësitë materiale dhe disiplinore

Z. Shala ka shprehur qëndrim politik pas zgjedhjeve nacionale të datës 06 tetor 2019, ku i kishte cilësuar pro-rus votuesit kosovar që votuan partinë fituese të atyre zgjedhjeve.[1]

Ky qëndrim publik, i shkruar në facebook e që më pas ishte bërë lajm në mediat vendore, konsiderohet shkelje e rëndë sipas Rregullores së RTK-së për Përgjegjësitë Materiale dhe Disiplinore, përkatësisht, neni 7, paragrafi 1,1 që shprehimisht e përcakton si shkelje të rëndë :*Sjellja brenda dhe jashtë vendit të punës që nuk përkon me statusin e punonjësit të RTK-së, e cila mund të rezultojë në prishjen e reputacionit dhe imazhit të RTK-së si institucion apo cilitdo punonjës të tij, duke përfshirë këtu edhe paraqitjet publike në mediat e tjera, rrjetet sociale dhe format e tjera të komunikimit publik*'

Me këtë deklarim, zoti Shala ka shkelur edhe paragrafët 1.7 dhe 1.21 të nenit 7 të Rregullores për Përgjegjësi Materiale dhe Disiplinore, me të cilat veprimet e lartpërmendura kualifikohen si:

1.7 Angazhim publik promocional në dëm të misionit të RTK-së si transmetues publik, duke përfshirë dhe angazhimet dhe deklarimet politiko-editoriale.

1.21 Vepron kundër apo në dëm të interesave të RTK-së

Dëmtimi i imazhit të RTK-së

Z. Shala po ashtu ka dëmtuar imazhin e RTK-së, pasi në maj të vitit 2021, duke qenë zëvendësdrejtor gjeneral i RTK-së, kishte përdorur gjuhë seksiste ndaj një deputeteje të Kuvendit të Kosovës[2].

Me këtë qëndrim, Z. Shala ka bërë shkelje të nenit 7, paragrafit 1.1 dhe 1.7 të Rregullores për Përgjegjësi Materiale dhe Disiplinore.

Në vazhdim, janë edhe disa deklarime të evidentuara të z. Shala që janë shkelje të ligjit të RTK-së dhe akteve nënligjore:

https://insajderi.com/drejtori-rtk-se-pas-vjedhe-partite-e-tjera-kutite-ashiqare-qysh-kish-reaguar-vv/

https://insajderi.com/drejtori-rtk-se-ia-atribuon-kadri-veselit-meritat-per-njohjen-nga-madagaskari/

[1] https://insajderi.com/drejtori-i-rtk-se-pi-kafe-me-shalen-qe-i-quajti-pro-ruse-votuesit-e-vetevendosjes/
[2] https://insajderi.com/kallxom-kur-po-dalim-doarse-mentor-shala-i-rtk-se-me-gjuhe-fyese-ndaj-deputetes/

Pos qëndrimeve politike, z. Shala nuk ka ndërmarrë asnjë masë për të përmirësuar gjuhën denigruese dhe shpërndarjen e lajmeve të paverifikuara në median online të RTK-së, rtklive.com. Duke qenë i ngarkuar me detyrën menaxhuese të portalit, z. Shala ka bërë shkelje të rëndë të detyrave të punës, përkatësisht Nenit 7, paragrafit 1.42 duke mos ndërmarrë masa ndaj stafit për publikimin e lajmeve të paverifikuara.

Në nenin 34, paragrafi 2 të Rregullores për Kompetenca dhe Përgjegjësi, përcaktohet se udhëheqësi i mediave online, bartë përgjegjësi editoriale për të gjitha publikimet si tekstuale ashtu edhe vizuele në mediat online.

Disa nga shembujt:

https://www.rtklive.com/sq/news-single.php?ID=518759

https://www.epokaere.com/ministrja-haxhiu-reagon-pas-raportimit-per-prokuroren-e-shperblyer/

https://www.rtklive.com/sq/news-single.php?ID=380163&fbclid=IwAR0_x58-ËI5CCZ06gatZtW3cB8vE_10Plgl7fPVwVOb4GzSYI0v2H1KeMp8

https://www.botasot.info/aktuale-lajme/1163779/shba-pergenjeshtron-lajmet-se-njeriu-i-trumpit-perkrah-kadri-veselin/?fbclid=IwAR1kS3i6ih-Zqc9hOV3eCd-l3McCs09E1RIdWpZEQMhqRTxAmI74YSXMLq8

https://www.rtklive.com/sq/news-single.php?ID=381283&fbclid=IwAR0kO5Crkln8yMtHdism7tR7CZRIEECcRUGC0OoPwqQ552WLfhUfqxD1nvM

Madje, në portal, janë publikuar lajme me qëndrime të stafit editorial. Në vend se të ndërmerren masa për shkelje të rregulloreve të punës, rtklive.com, ka bërë lajm deklarimet e të punësuarit të RTK-së, i cili ka masë të shqiptuar disiplinore, vërejtje e fundit me shkrim.

https://www.rtklive.com/sq/neës-single.php?ID=587804

https://www.rtklive.com/sq/neës-single.php?ID=587393

Përkeqësimi i situatës financiare të RTK-së

Gjatë kohës sa ka qenë drejtor gjeneral i RTK-së z. Shala ka dështuar të përmirësojë situatën financiare, duke rritur borxhet në shkallë enorme. Siç tregojnë edhe pasqyrat financiare të RTK-së për vitin 2013, borxhet në atë kohë ishin në vlerë prej 3,3 milionë Eurosh, ndërkaq pas 5 vitesh menaxhim të RTK-së nga z. Shala, sipas këtyre pasqyrave, borxhet janë rritur në 5.2 milionë Euro.

https://www.rtklive.com/sq/pages/files/pf_dhe_rap_2018_AL.pdf

https://www.rtklive.com/pages/files/Raporti_Auditimit_2013_.pdf

Bordi i RTK-së, në vendimin e datës 19 janar 2022 për shkarkimin e ish drejtorit të përgjithshëm të RTK-së, konstaton se ***"Pjesëmarrja e të punësuarve në aktivitete të tilla me karakter debatues politik, publikimi i deklaratave të njëanshme politike në rrjetet sociale si dhe shpërndarja e përmbajtjes së mediave konkurrente nga personat e punësuar në RTK, dëmtojnë imazhin dhe pavarësinë editoriale të transmetuesit publik, për çfarë Drejtori i Përgjithshëm i RTK-së nuk ka marrë masat e duhura sipas rregullativës në fuqi".***

Duke u nisur nga shkeljet e lartcekura dhe dështimi në menaxhim të RTK-së, bazuar në përgjegjësitë e përcaktuara me ligj të RTK-së dhe akteve të tjera nënligjore, konstatoj se z. Shala nuk mund të jetë pjesë e ekipit menaxhues të transmetuesit publik, pasi i njëjti me veprimet të përsëritura, ka dëmtuar imazhin e transmetuesit publik dhe ka dëmtuar qëndrueshmërinë financiare të RTK-së.

UD i Drejtorit të Përgjithshëm konstaton se nuk mund të ketë bashkëpunëtorë të cilët janë përgjegjës për shkelje të vazhdueshme dhe prishje të imazhit të RTK-së. Kjo konkluzë rrjedh edhe nga vendimi i Bordit të RTK-së i datës 19 janar, për shkarkimin e ish-Drejtorit të Përgjithshëm.

Me nenin 19, paragrafi 9 i Statutit të RTK-së është përcaktuar se UD i Drejtorit të Përgjithshëm do t'i ushtrojë të gjitha kompetencat e Drejtorit të Përgjithshëm, të përcaktuara sipas ligjit të RTK-së, e kjo përfshin edhe përgjegjësitë për t'i propozuar bordit të RTK-së, emërimin dhe shkarkimin e bashkëpunëtorëve të ngushtë, menaxhmentit të lartë.

Prandaj, UD i Drejtorit të Përgjithshëm, duke u bazuar në detyrat dhe përgjegjësitë e tij, shkeljeve të vazhdueshme nga ana e z. Mentor Shala dhe provave të paraqitura më lart, i propozon Bordit të RTK-së shkarkimin e z. Mentor Shala nga pozita e Zv. Drejtorit të Përgjithshëm. Pas këtij vendimi, sipas rregullativës ligjore së RTK-së, z. Shala do të risistemohet.

Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.

Kryetar i Bordit të RTK-së

Besnik Boletini

Vendimi iu dërgohet:

- Z. Mentor Shala;
- Anëtarëve të Bordit të RTK-së;
- Menaxhmentit të lartë të RTK-së;
- Sekretarisë së Bordit;
- Arkivit.

Prishtinë, 29 janar 2022

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij vendimi, pala e pakënaqur mund të iniciojë kontest pune në Gjykatën Themelore në Prishtinë, në afat prej 30 ditësh nga dita e pranimit të këtij vendimi.